

VENDIM
Nr. 345, datë 15.5.2019

PËR DHËNIEN E MANDATIT TË DEPUTETIT TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË, KANDIDATIT TË LISTËS SHUMEMËRORE TË PARTISË SOCIALISTE, QARKU KORÇË, PËR PLOTËSIMIN E VAKANCËS SË NJOFTUAR NGA KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e datës 15.5.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement Zguri: kryetar;

Denar Biba: zv.kryetar;

Bledar Skënderi: anëtar;

Edlira Jorgaqi: anëtare;

Rezarta Bitri: anëtare,

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, kandidatit të listës shumëmemërore të Partisë Socialiste, qarku Korçë, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë, pas dorëheqjes nga mandati i deputetit, të z. Ilir Telha Xhakolli.

KËRKUES: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa “a”, neni 164, pika 2, i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

VËREN:

Nëpërmjet shkresës nr. 1976/1 prot., datë 13.5.2018, drejtuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, z. Genci Gjonçaj, njofton krijimin e vakancës në Kuvendin e Shqipërisë, për shkak të përfundimit të parakohshëm të mandatit të deputetit të zonës zgjedhore, qarku Korçë.

Neni 164, i Kodit Zgjedhor, përcakton se në rast të ndërprerjes së mandatit të deputetit, Kuvendi njofton Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, për krijimin e vakancës në Kuvendin e Shqipërisë dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve merr vendim për dhënien e mandatit, kandidatit të radhës në listën shumëmemërore, të së njëjtës parti politike në zonën zgjedhore përkatëse, regjistruar sipas nenit 67, të Kodit Zgjedhor.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 555, datë 26.7.2017, shpalli rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë datë 25.6.2017, si dhe miratoi listën emërore të deputetëve të zgjedhur për çdo subjekt për çdo zonë zgjedhore. Sipas vendimit të sipërcituar Partia Socialiste e Shqipërisë për zonën zgjedhore qarku Korçë, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 qershor 2017, ka fituar 6 (gjashtë) mandate dhe kandidatët fitues nga lista shumëmemërore e Partisë Socialiste, qarku Korçë, janë numri rendor 1 (një) z. Niko Aleks Peleshi, numri rendor 2 (dy) z. Eduard Pajtim Shalsi, numri rendor 3 (tre) znj. Elisa Aleksandër Spiropali, numri rendor 4 (katër) z. Ilirian Anesti Pendavinji, numri rendor 5 (pesë) z. Ilir Telha Xhakolli, numri rendor 6 (gjashtë) znj. Edlira Përparim Bode.

Rezulton se lista shumëmemërore e Partisë Socialiste, qarku Korçë, i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67, të Kodit Zgjedhor, duke përfshirë dhe kriterin e gjinisë. Në këto kushte zëvendësimi i vakancës do të bëhet sipas përcaktimeve të nenit 164, pika 2, të Kodit Zgjedhor me kandidatin e radhës.

Në bazë të nenit 164, pika 2, e Kodit Zgjedhor, KQZ-ja i ka kërkuar kandidatit vijues të listës shumëmemërore me numër rendor 7 (shtatë), dorëzimin e formularit të vetëdeklarimit në zbatim të

ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Z. Ardit Petrika Konomi, referuar ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve më datë 14.5.2019, formularin e vetëdeklarimit me numër unik 4668.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të z. Ardit Petrika Konomi, rezulton se, në seksionin III “Të dhëna mbi gjendjen gjyqësore të personit”, në pikën nr. 5 “A keni qenë ndonjëherë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligjzbatuese, për kryerjen e një vepre penale”, i është përgjigjur “Po” duke dhënë informacionin si vijon:

- Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Korçë, e ka ndaluar në shtator 1997, për arsye të shkeljeve të rregullave të qarkullimit rrugor, dhe e ka dërguar çështjen për gjykim. Ndaj tij është vendosur masa shtrënguese e sigurisë “Arrest në shtëpi”.

Me vendimin nr. 165, datë 30.12.1997, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, ka akuzuar z. Ardit Petrika Konomi për veprën penale “Shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni nr. 290/1, ndaj të cilit është vendosur pushim i gjykimit të çështjes.

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” dhe kreut V, pika 2, germa “b”, dhe pikës 3, germa “c”, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015”, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me shkresën nr. 2596 prot., datë 15.5.2019, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe me shkresën nr. 2595 prot., datë 15.5.2019, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore, për kandidatin për deputet, Qarku Korçë, për Kuvendin e Shqipërisë, z. Ardit Petrika Konomi.

KQZ, gjithashtu ka bërë publikimin e formularit të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Me shkresën nr. V-1499/1 prot., datë 15.5.2019, zyra e gjendjes gjyqësore ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatin për deputet, Qarku Korçë, për Kuvendin e Shqipërisë, z. Ardit Petrika Konomi, sipas së cilës rezulton i padënuar.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile nuk i ka kthyer ende përgjigje kërkesës sonë.

Nga verifikimi i dokumentacionit (të dhënave në formularin e vetëdeklarimit dhe vërtetimit të gjendjes gjyqësore) sipas nenit 2, dhe nenit 4, të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, rrethanat e paraqitura nga z. Ardit Petrika Konomi, nuk përfshihen në kushtet e ndalimeve për kandidim dhe për t’u zgjedhur në funksionin e deputetit.

Për sa më sipër, mandati i ndërprerë i përket kandidatit të radhës të listës shumëmemërore e Partisë Socialiste, në zonën zgjedhore qarku Korçë, i renditur me numër rendor 7 (shtatë), z. Ardit Petrika Konomi.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, mbështetur në nenin 23, pika 1, germa “a”, neni 164, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. T’i japë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumëmemërore të Partisë Socialiste, Qarku Korçë, z. Ardit Petrika Konomi.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

KRYETAR
Klement Zguri